

LETËRSI

Shkrimtari Arian Leka mori pjesë në përrurimin e antologjisë "Das Hemd / Këmisha. 1863 - 1914 - 2014", përkthyer nga Zuzane Finger, takim ky i organizuar në Qendrën Kulturorë në Graz, në përkujtim të Luftës së Parë Botërore. Të 33 autorët e përzgjedhur në këtë antologji sollën krijimtarinë e tyre në ese, tregime dhe poezi, në përkujtim, echo apo me vokacion nga Lufta e Parë Botërore. Autorët vijnë nga ish-tokat e kurorës së Monarkisë Habsburge, nga vendet e përfshira në luftë, nga shtetet e Antantës dhe të Fuqive të Mëdha...

STAFF "MILOSAO"

Shkrimtari Arian Leka mori pjesë në përrurimin e antologjisë "Das Hemd / Këmisha. 1863 - 1914 - 2014", takim ky i organizuar në Qendrën Kulturorë në Graz, në përkujtim të Luftës së Parë Botërore.

33 autorët të përzgjedhur në këtë antologji sollën krijimtarinë e tyre në ese, tregime dhe poezi, në përkujtim, echo apo me vokacion nga Lufta e Parë Botërore. Autorët vijnë nga ish-tokat e kurorës së Monarkisë Habsburge, nga vendet e përfshira në luftë, nga shtetet e Antantës dhe të Fuqive të Mëdha. Tekstet prekin përvoja vetjake dhe fate njerëzore, që duke iu shmangur historisë, pasurojnë kujtesën me ngjarje që nuk kanë vend në Historinë e Madhe. Veprimtaria u zhvillua në prani të autorëve dhe u moderua nga Dr. Alida Bremer, me performancë teatrore nga Ninja Reichert dhe nën organizimin e Luise Grinschgl. Redaktor përgjegjës i botimit Max Aufischer.

Pikë referimi për të gjithë teksteve e botuara ishte këmisha si ikonë këmisha si veshje personale dhe si një arketip i jetës së përditshme, i ceremonive, ritualeve dhe ngjarjeve që e ndjekin njeriun nga pagëzimi deri ditën e mbrame të përcjelljes në varr.

Të tilla konotacione dhe kontekste përkruajnë tekstet e autorëve të botuar në këtë përzgjedhje të gjerë, në 504 faqe, nën ballinën ku sundon ngjyra gri sundon, si për të na kujtuar hirin e luftës që bie mbi një këmishë të paveshur, si dhe mbi të gjithë historinë botërore.

Në këtë mënyrë, projekti u krijua jo thjesht si një pikëvështrim austriak apo gjerman, por nga një perspektivë më e gjerë evropiane. Si imazh skenik, por edhe si simbol kryesor letrar në këtë krijimtarinë ishte "këmisha", e zgjedhur enkas për të theksuar pjesëmarrjen, rolin dhe angazhimin personal të individit në histori. Theksi ra mbi historitë e vogla, ngjarjet njerëzore, të pathënat, të pashkruar.

Historitë në këtë libër tërheqin vëmendjen për faktin se në ngjarje të mëdha fatet njerëzore shpërfillen. Tekstet e kësaj antologjie janë botuar përkatesisht në gjuhën amtare të autorit me përkthimin gjermanisht. "Das Hemd / Këmisha / 1863 - 1914 - 2014" është një ngjarje letrare e organizuar nga Kunstvermittlung Steiermark - Kunstpädagogisches Institut Graz - Haus für Autorinnen und Autoren - Graz. Botues Leykam, nëntor 2014.

Teksti i shkrimtarit Arian Leka në këtë antologji është një ese e veçantë në trajtim dhe në formë një fakt/ fiction, që ndërthur jetën personale të autorit me historinë e vendit të tij. "Në kërkim të këmishës së humbur" përkthyer në gjermanisht nga Zuzane Finger "Auf der Suche nach dem verlorenen Hemd..." është jeta e një njeriu të lindur me këmishë, vendosur nëpër një labirint ngjarjesh që i shkruhen në lëkurë. Takime të pazakonta me fatin, objekte me vlera të rralla, që ndikojnë në jetë dhe njerëz që përpiqen t'ia ndryshojnë drejtimin. Teksti është ndërtuar me 5 njësi.

I (fragment) Kur Qershori të gjen në Sarajevë, është mirë të mbrohet. Qershori në Sarajevë është si Marsi për shqiptarët, si Prilli për britanikët: muaj i vrazhdë, përzier kujtesën me dëshirën, trazon rrënjët e plogëta, rrit zambakë mbi dheun e të vdekurit. Ndaj kryej punë, rrëmbe dikça si kujtim dhe ik pa kthyer sytë! Jo gëzhoja stilolaps, trofetë e luftërave ndëret-

Arian Leka përcjell "Këmishën" në Graz

Përmes elementit të Këmishës, autorë ballkanikë, që vinë nga trevat nën perandorinë e Monarkisë Habsburgase kanë përcjellë emocionet e tyre me një element të vetëm, me fabula të ndryshme për Luftën e Madhe të 100-viteve më parë...



Autori në aktivitet

nike. As punime prej bakri të rrahur mjeshhtërisht. Gjej një këmishë, një këmishë që të mbiron.

II (fragment) Këmisha e lindjes nuk ishte e vetmja që kam ndeshur në jetë. Në një qoshk të korridorit, mbështetur si me shpatulla pas muri, rrinte orendia më e madhe e shtëpisë. Ngjante se kishte ngecur aty, poshtë reve, diku mes themeleve dhe trarëve të çatisë. Ishte dollap, por ngjante si anije... Nuk duhet të ketë pasur prehje brenda tij. Veshjet tona, të shtëpisë, në njërin anë. Në anën tjetër vareshin rrobrot armike. Modelet e këmishëve të thjeshta të punës i kundërviheshin sqmës së leshtë të endur hollë dhe butësisë së mëndafshit. Rrobrot me aroma burri, përballë kostumeve me vijë dhe këmishëve me jaka të ngrira. Shpirti i lig i të zotëve, pëshpëritej se jetonte aty. Nuk duheshin prekur me dorë. Krezik vdekje! Tension i lartë! Nuk do çuditësia aspak nëse një ditë, prindërit, të pikturonin mbi kanatin e ndaluar të dollapit ndonjë kafkë... Në dollap, kishte dy lloj errësirash. Tjetër ishte errësira që pllakoste kur mbyllja kanatet. Tjetër ishte errësira që binte kur mbyllja sytë. Aty nuhata për herë të parë se profesionet nuk ishin zanate. As mjeshhtëri. Nuk mësoheshin. Ishin në gjak. Me profesionin lindje, siç kisha lindur unë mbështjellë me placentë. Por profesionet ishin dhe veshje. Pantallona, xhaketë, këpuce, galloshe, çizme, shoshohe, kapota dhe mushama kundërshi. Më tepër se gjithçka, profesionet ishin këmishë.

III (fragment) Kopshti i shtëpisë së gjuhërishte ishte si një këmishë, mbi të cilin kishin pikturuar zogj, fruta, pemë. Kopshti ishte natyrë - plotësonte gjithësisht i mungonte shtëpisë. Natyra nuk ishte si ne. Natyra çmendej. Thuajse përditë. Lëvoret, sythet,

rrënjët, bulat, lulet, rrënjët dhe gjethet, çarteshin sa herë që ndjenin afsh rrezesh dhe afrimin e lagështirës së shiut. Farat kur thithnin diell, plasat kur mblidhnin dyll, lëngjet kur rridhnin fshehtë, frutat kur ndryshonin ngjyrë, çmendeshin fare pas dritës së hënës dhe pas reve. Pemët, drurët, farat, bimët dalldisnin edhe për ne, njerëzit e shtëpisë. Ato çmendeshin për ne, që nuk mund të çmendeshim. Por nuk mbaroi aty. Si të ishin penduar për këmishën që ma kishin zhvatuar, prindërit dhe mësuesit më dhuruan një këmishë të re. Isha bërë tamam burrë thënë ndryshe isha 10 vjeç. Më këtë rast organizuan një ceremoni në varrezën e dëshmorëve. Aty më veshën një këmishë të pastër, të bardhë. Në qafë më lidhën një shall të kuq. Nuk zhgënjeva njeri. E thashë qartë. Siç e kërkonte rasti. Pa asnjë gabim. "Beto hemd përpara flamurit dhe shokëve të mi pionierë, se do punoj, mësoj dhe do të jem bir i denjë i mësimëve të Partisë dhe xhaxhit Enver. Do jem gati të derdh edhe pikën e fundit të gjakut për të mbrojtur atdheun socialist". Kështu kishin bërë të gjithë para meje. Këtë betim bënë pas meje edhe të tjerë.

Këmisha...

Kjo është një ndërthurje e historisë personale të një fëmije të lindur me këmishë, me historinë e një vendi me zonat e tij më tramautike të tij, si humbja e lirisë themelore, fjala, lëvizja, prona, besimi, ateizmi, kolektivizimi (si ironi e globalizimit primitiv) privatja etj. Sa me fat ishte ky fëmijë i rritur në një vend absurd si ky - pse duhet të lindesha me këmishë kur ta shqyenin nga trupi që ditën e parë...

IV (fragment) Më fanepsen në ëndrra. Këmishë fluturoese. Këmishë profesionale. Këmishë force për të çmendurit. Placenta të shqyera, të përgjakura, të flakura. Si këmisha das hemd i arkiudukës së vrarë në Sarajevë. Hapin mëngët sikur kërkohet të më rrëmbejnë për të më çuar diku tjetër. Përse kërkoni të më rrëmbejnë? Përse donin të më ngjiteshin në trup? Të jenë këmishët që jam përpjekur të shmang në jetë? Profesione që dëshatuan te unë?

Nga im gjysh, partizani i Brigadës së VIII Sulmuese, të Herakliu mitologjik kalohet si të kapërcesh një vah. Luftëtarë që të dy, po nuk vdiqën në luftë, siç e kërkon pathosi dhe epika. Vdiqën gjakshprishur, të helmuar. Po. Nga një këmishë. Për hir të dashurisë fatale. Vdiqën prej Erosit politik. Erosit të veshur me këmishë dhe kollare. Kishin lindur heronj në fund të epokës heroike, siç unë kisha lindur me këmishë në kohë ateistësh filistinë...

Dikush vazhdon ti besojë shqisës estetike të Proust-it dhe vihet në kërkim të kohës së humbur. Një tjetër gjen rrugë më të ashpër. Atë që zgjodhi Adam Michnik-u, kur u vu të gjente arsyt përse e humbim sensin, domethëniet, kuptimin, kur kemi më shumë liri, më shumë institucione udhëzuese dhe pse përfundojmë, siç dihet, në disidentë të konvertuar, deri në pendim. Ndërkaq, rregulli Askush nuk dhuron asgjë! Kishte ndryshuar. Pavarësisht nëse jeton në Graz, Tiranë apo në Sarajevë, kush lind me këmishë, jo me parë, as me placentë, por me shtatë palë lëkurë ka për ta paguar, atë që i është dhënë vetëm atij, ndërsa gjithë të tjerëve u është mohuar.

